

**URDHËR**  
Nr. 190/1, datë 26.5.2020

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË URDHRIN NR. 190, DATË 19.3.2020  
“PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE ARSIMORE  
PUBLIKE DHE JOPUBLIKE DHE ÇERDHEVE PËR KUFIZIMIN E PËRHAPJES  
SË INFEKSIONIT COVID-2019”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, germa “a”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

**URDHËROJ:**

Në urdhrin nr. 190, datë 19.3.2020 “Për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore publike dhe jopublike dhe çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-2019”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, pas togfjalëshit “institucioneve arsimore publike dhe jopublike”, hiqet togfjalëshi “dhe çerdhe”.
  2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me përmbajtje si vijon:  
“1/1. Lejohet hapja e veprimtarisë së çerdheve dhe kopshteve duke filluar nga data 1.6.2020 e në vijim, në përputhje me protokollet e miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik”.
  3. Çdo urdhër që bie në kundërshtim me pikën 2 të këtij urdhri, shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**Ogerta Manastirliu**